

NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

LICENCIME

SEANCA DËGJIMORE

Gjatë muajit prill, Enti Rregullator i Energjisë ka filluar procedurat e licencimit për subjektet e mëposhtme:

1. Për rinovimin e licencës së shoqërisë “AEE” shpk në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
2. Për rinovimin e licencës së veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali TEC (përpunimi i mbetjeve urbane), Qarku Elbasan, me kapacitet të instaluar 2850 kW.
3. Për rinovimin e licencës së shoqërisë “ENER TRADE” shpk, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, si dhe për rinovimin e licencës së shoqërisë “ENER TRADE” shpk, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË, ERE, NË DATËN 04 PRILL, ZHVILLOI NJË SEANCË DËGJIMORE ME QËLLIM DISKUTIMIN ME PALËT E INTERESIT NË LIDHJE ME DISA NDRYSHIME NË ZBATIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-S NR. 23, DATË 14.02.2022 “RREGULLORE MBI MASAT E TË LICENCUARVE NË AKTIVITETIN E FURNIZIMIT PËR ARRITJEN E TREGUESVE TË MATJES DHE VLERËSIMIT NGA ERE TË PERFORMANCËS SË SHËRBIMIT NDAJ KLIENTIT”.

NË KËTË SEANCË, NË TË CILËN U FTUAN TË MARRIN PJESË TË GJITHË PALËT E IDENTIFIKUARA TË INTERESIT, MORRËN PJESË PËRFAQËSI TË MINISTRISË SË SHËNDETËSISË, AVOKATIT TË POPULLIT, SHOQATËS SË FURNIZUESVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE - AAES, FTL SH.A., OSSH SH.A., AGJENSISË SË MBROJTJES SË KONSUMATORIT, TIRANË, ALBPETROL SH.A., “XHENGO ENERGJI” SH.P.K. SI DHE “H&K@VALA MAR RESIDENCES” SH.P.K, TË CILËT SHPREHËN QËNDRIMET E TYRE NË LIDHJE ME PROPOZIMIN E SHOQATËS SË FURNIZUESVE PËR SHTYRJEN E AFATEVE TË IMPLEMENTIMIT TË DISA PREJ PARASHIKIMEVE TË KËSAJ RREGULLOREJE, DERI NË 31.12.2023. NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË MBLEDHJES SË KOMENTEVE TË PALËVE TË INTERESIT DHE SHQYRTIMIT TË PROPOZIMEVE E QËNDRIMEVE TË PËRCJELLA, ERE DO TË SHPREHET NË

LIDHJE ME KËTË KËRKESË TË SHOQATËS SË FURNIZUESVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE - AAES.



NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

ALPEX

VENDIME

NJOFTIME

Në mbledhjen e zhvilluar më datë 14 prill 2023, Bordi i ERE-s shqyrtoi dhe miratoi Kufirin Minimal dhe Maksimal të Lejuar të çmimit për Tregun e Ditës në Avancë për operimin e Jo-Bashkimit të Tregjeve, ku Kufiri Maksimal i Lejuar i çmimit për Tregun e Ditës në Avancë: + 900 €/MWh. Dhe Kufiri Minimal i Lejuar 0 €/MWh. Miratimi i këtyre kufijve është një mekanizëm i rëndësishëm i cili mbron tregun nga çmime të cilat mund të çojnë në deformime të panevojshme të tregut të energjisë elektrike. Këto kufij do të shërbejnë për një periudhë tranzitore deri në momentin që ALPEX sh.a. do të vlerësojë se tashmë tregu i organizuar me shumicë i energjisë elektrike është maturuar mjaftueshëm, do të paraqesë për miratim përsëri në ERE një propozim për heqjen e këtyre kufijve.

Ankandi i parë live u zhvillua nga ALPEX sh.a. në datën 11.04.2023 në prani të të gjithë aktorëve dhe bashkëpunëtorëve që çuan në hapjen e Bursës Shqiptare të Energjisë.



Po këtë muaj, Bordi i ERE-s ka zhvilluar gjashtë mbledhje, të cilat kanë rezultuar në 30 vendimmarrje. Këto të fundit kanë rezultuar në licencimin e një subjekti në prodhimin e energjisë elektrike nga central fotovoltaik, një subjekti në furnizimin e energjisë elektrike, një subjekti në tregtimin e energjisë elektrike si dhe miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin mars 2023 prej 20.49 Lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, por dhe vendime mbi çështje të brendshme të organizimit të institucionit. Gjithashtu, ndër vendimmarrjet me rëndësi të marra gjatë këtij muaji përmendim rinovimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike nga centrali i përpunimit të mbetjeve urbane, për shoqërinë ECO-ELB; modifikimin e licencës së shoqërisë Kurum sh.a., sa kërkuar nga kjo e fundit, për rritjen e kapacitetit të prodhimit të energjisë nga HEC-i "Shkopet" tashmë me një kapacitet prodhimi prej 28MW; Pajisjen me Certifikatë të Garancisë së Origjinës, të impiantit të prodhimit të energjisë elektrike "HEC Banjë" për sasinë e prodhuar të energjisë elektrike 167,931 MWh, si dhe të impiantit të prodhimit të energjisë elektrike "HEC Moglicë" për sasinë e prodhuar të energjisë elektrike 322,491 MWh, të shoqërisë "DEVOLL HYDROPOWER", për një periudhë 12-mujore secilën (01.01.2022 - 31.12.2022). Pjesë e axhendës mujore kanë qënë dhe seancat dëgjimore që lidhen me trajtimin e ankesave të konsumatorëve por jo vetëm.

Për tu azhornuar me informacion më të detajuar, shfletoni faqjen tonë zyrtare.



[Çmimet e miratuara nga ERE për Energjinë Elektrike të Prodhuar nga Centralet që shfrytëzojnë Burime të Rinovueshme në Energji si dhe nga Burimet e Vogla Gjeneruese Fotovoltaike dhe Eolike](#)

[Tarifat dhe Çmimet e Energjisë Elektrike dhe Gazit Natyror për vitin 2023](#)

[LEXO MË SHUMË MBI CERTIFIKATAT E GARANCIVE TË ORIGJINËS.](#)

NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

VARFËRIA ENERGJITIKE

UDHËRRËFYES

PËRDORIMI I ENERGJISË ËSHTË THELBËSOR PËR TË SIGURUAR NJË STANDARD TË PËRSHTATSHËM JETESE DHE SHËNDETI. NË EVROPË, VARFËRIA ENERGJETIKE ËSHTË NJË SHQETËSIM NË RRIJJE QË VË NË RREZIK SHËNDETI DHE MIRËQENIEN E MILIONA QYTETARËVE. SIPAS VLERËSIMEVE TË FUNDIT, TË PUBLIKUARA NGA PARLAMENTI EUROPIAN REZULTON SE RRETH 36 MILION QYTETARË TË BASHKIMIT EUROPIAN NUK MUND T'I MBAJNË SHTËPITË E TYRE TË NGROHTA NË MËNYRË ADEKUATE.

PËRKUFIZIMI I VARFËRISË ENERGJETIKE NUK ËSHTË ENDE I HARMONIZUAR NË TË GJITHË EVROPËN. PËRGJITHËSISHT PËRKUFIZIMI LIDHET ME PAMUNDËSINË PËR TË SIGURUAR SHËRBIME TË MJAFTUESHME TË ENERGJISË NË SHTËPI DHE ËSHTË E LIDHUR ME CËNUESHMËRINË, E CILA NË KONTEKSTIN E DISKURISIT TË POLITIKAVE TË BE-SË, LIDHET ME AFTËSINË E KUFIZUAR TË FAMILJEVE PËR TË AKSESUAR PLOTËSISHT PËRFITIMET E OFRUARA NGA TREGJET E BRENDSHME TË ENERGJISË.

VARFËRIA E ENERGJISË NË SHQIPËRI AKTUALISHT LIDHET ME MERRET ME VULNERABILITETIN NË TERMIN KLIENT NË NEVOJË, NDËRSA NDIHMA SOCIALE ËSHTË I VETMI MJET I NDËRHYRJES SË VAZHUESHME PËRMES BUXHETIT TË SHTETIT. PËR MË TEPËR, ASPEKTE TË TJERA TË VARFËRISË SË ENERGJISË, SI QASJA NË BURIME TË LARMISHME DHE KONKURUESE TË ENERGJISË, KONSUMIN EFIKAS TË FAMILJEVE, AJËR TË PASTËR, FUQIZIMI I KONSUMATORËVE NË TREG ETJ KA GJETUR VEND SË FUNDIT. VARFËRIA ENERGJITIKE SI NJË KONCEPT KOMPLEKS KËRKON BASHKËPUNIM NË TË GJITHA NIVELET, SI TË PUSHTETIT QËNDROR, ATIJ VENDOR, INSITUACIONEVE SPECIFIKE ME EKSPERTIZË NË SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE, ÇKA DO TË MUNDËSONTE JO VETËM MBËSHTETJE FINANCIARE POR DHE MBËSHTETJE PROFESIONALE NË VLERËSIMIN E ZGJEDHJEVE TË DUHURA QË NDIKOJNË NË EFICENCËN E ENERGJISË DHE ULIN KOSTOT E SIGURIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE. NË KËTË KOMPLEKSITET, RREGULLTORI KA NJË ROL TË RËNDËSISHËM NË BALANCIMIN E INTERESAVE TË KONSUMATORIT, QEVERISË DHE INVESTITORIT (OPERATORË TË SHËRBIMEVE TË FURNIZIMIT ME ENERGJI).

STUDIMI I ERE-S KA PËR QËLLIM TE OFROJE NJË PREZANTIM TË PËRGJITHSHËM TË ASAJ QË ËSHTË BËRË TASHMË NË NIVELIN E BE, VENDEVE TE TRAKTATIT TE KOMUNITETIT TË ENERGJISË SI DHE NË VENDIN TONË. OBJEKTIVI KRYESOR ËSHTË TË IDENTIFIKOHEN DHE TË VIHET NË DISPOZICION NJË INFORMACION MBI EKSPERIENCAT DERI MË TANI, MBI VARFËRINË ENERGJITIKE, KONCEPTIN E PËRGJITHSHËM, DIMENSIONET E SAJ, FAKTORËT DHE MEKANIZMAT MBËSHTETËS PËR ZBUTJEN E VARFËRISË ENERGJITIKE.

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË (ERE) ËSHTË NJË ENT PUBLIK QË TRAJTON ÇËSHTJET QË LIDHEN ME LICENCIMIN E SUBJEKTEVE TËCILAT OPEROJNË NË TREGUN E ENERGJISË ELEKTRIKE DHE GAZIT NATYROR, PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË OPERATORËVE TË RRJETIT TË TRANSMETIMIT DHE SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE DHE GAZIT NATYROR SI DHE ÇMIMET PËR KLIENTËT E SHËRBIMIT UNIVERSAL, ÇERTIFIKIMIN E OPERATORIT TË RRJETIT TË TRANSMETIMIT, MONITORIMIN E TREGUT TË ENERGJISË, MIRATIMIN E PLANEVE TË OPERATORËVE TË RRJETIT, TRAJTIMIN E ANKESAVE TË KONSUMATORËVE DHE ZGJIDHJES SË MOSMARRËVESHJEVE NDËRMJET TË LICENCUARVE. ERE NË USHTRIMIN E DETYRAVE EKUILIBRON INTERESAT E INVESTITORËVE, KONSUMATORËVE DHE SHTETIT PËR TË SIGURUAR NGA TË LICENCUARIT SHËRBIM TË SIGURT DHE TË BAZUAR NË KOSTO TË ARSYESHME. ERE GJITHASHTU SHËRBEEN SI BURIM INFORMACIONI NË LIDHJE ME SHËRBIMET E OFRUARA NGA TË LICENCUARIT DHE NË TËRËSI PËR KUADRIN RREGULLATOR. PËRVEÇ KËSAJ ERE ËSHTË E PËRFSHIRË AKTIVISHT NË ORGANIZATAT RAJONALE, APO DHE NË MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI NË LIDHJE ME ÇËSHTJET E SHËRBIMEVE QË NDIKOJNË NË TREGUN E ENERGJISË. SI PJESË E ROLIT TË SAJ, ERE PËRPIQET TË JETË E HAPUR DHE TRANSPARENTE NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE NDAJ TË GJITHA PALËVE TË INTERESUARA. UDHËRRËFYESI I SHËRBIMEVE DO TË SHËRBEJË SI NJË BURIM QË PËRMBAN INFORMACIONE APO SHPJEGIME PËR PROCESIN DHE PROCEDURAT RREGULLATORE NË SEKTORIN E ENERGJISË.

UDHËRRËFYESI